



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 17

Tiranë – E hënë, 13 korrik 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 4174/1, datë 9.7.2026	Për shprehje interesi për kandidatët që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme.....	3
Kërkesë e Ministrisë Mjedisit nr. 3904/1, datë 9.7.2026	Për shprehje interesi për shërbime konsulence – përzgjedhja e firmave – “Asistencë teknike për planifikimin e investimeve në pyllëzim, përmirësimin e kullotave dhe kontrollin e erozionit”.....	3
Njoftim i Korporatës së Investimeve Shqiptare nr. 334/7, datë 9.7.2026	Për procedurën konkurruese për kontratën “Projektimi dhe zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i objektit multifunksional në Njësinë Administrative nr. 7, zona urbane e ish-Fushës së Aviacionit, Tiranë”.....	7

**KËRKESË**

Nr. 4174/1, datë 9.7.2026

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR
KANDIDATËT QË KËRKOJNË TË
CERTIFIKOHEN SI NDËRMJETËS TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, që kërkon të certifikohet si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme, depoziton pranë Ministrisë së Drejtësisë, përmes shërbimit postar ose dorazi, dokumentacionin bashkangjitur:

1. Kërkesë për shprehje interesi për certifikimin si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme;

2. Kopje të mjetit të identifikimit;

3. Certifikatë familjare;

4. Kopje të njësuar të diplomës së arsimit të mesëm të lartë, të lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Shqipërisë, ose diplomë të lëshuar nga institucion arsimor i huaj, të njohur e të njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;

5. Vërtetim nga prokuroria që nuk është nën hetim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit, apo të armëve të shkatërrimit në masë;

6. Vërtetim nga gjykata që nuk është nën gjykim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;

7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore të kandidatit dhe për personat e lidhur me të;

8. Vetëdeklarim që nuk ka dënim me masë administrative gjorbë, ose masë administrative që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune, apo biznesi, si dhe të mos e përsërisë në të ardhmen, për shkelje të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, të paktën jo më herët se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;

9. Certifikatë për përfundimin me sukses të programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme;

10. Dokument që provon zotërimin e gjuhës shqipe, të lëshuar nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi (për shtetasin e huaj).

KËRKESË

Nr. 3904/1, datë 9.7.2026

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR
SHËRBIME KONSULENCE –
PËRZGJEDHJA E FIRMAVE –
“ASISTENCË TEKNIKE PËR
PLANIFIKIMIN E INVESTIMEVE NË
PYLLËZIM, PËRMIRËSIMIN E
KULLOTAVE DHE KONTROLLIN E
EROZIONIT”**

Emri i Projektit: **Mjedis i Pastër dhe me Aftësi Ripërtëritëse për Detin Blu (Care4BlueSea)**

Nr. i huas: **95070-AL**

Nr. i ID-së së Projektit: **P176163**

Titulli i detyrës: **Asistencë teknike për planifikimin e investimeve në pyllëzim, përmirësimin e kullotave dhe kontrollin e erozionit**

Nr. reference: **AL-MTE-2.3.1-1-CS-CQS**

Ministria e Mjedisit ka siguruar financim nga Banka Botërore për Projektin Care4BlueSea dhe synon të përdorë një pjesë të këtij financimi për shërbime konsulence.

Shërbimet e konsulencës (“Shërbimet”) përfshijnë përgatitjen e një plani investimi të verifikuar në terren, të kostuar dhe të zbatueshëm për ndërhyrje në pyllëzim/ripërtëritje bimore, përmirësim të kullotave dhe kontroll të erozionit në zonat prioritare të Pellgut të Lumit Vjosa. Shërbimet duhet të jenë praktike, të bazuara në evidencë dhe të përshtatshme për përdorim të drejtpërdrejtë në fazën pasuese të zbatimit, duke përfshirë:

- fazën fillestare, mbledhjen e të dhënave dhe metodologjinë për përzgjedhjen e zonave, analizën e përshtatshmërisë, verifikimin në terren dhe koordinimin me palët e interesit;

- diagnostikimin GIS/mjedisor, verifikimin në terren dhe prioritizimin e zonave të ndërhyrjes në Pellgun e Lumit Vjosa;

- përzgjedhjen e modeleve të përshtatshme të restaurimit dhe të krijimit të mbulesës bimore, duke u dhënë përparësi qasjeve me risk të ulët,



mirëmbajtje të kufizuar dhe efektivitet financiar, aty ku janë të përshtatshme;

- përgatitjen e projekteve teknike të detajuara, hartave GIS, vizatimeve, specifikimeve, shënimeve të zbatimit dhe kërkesave të mirëmbajtjes për ndërhyrjen prioritare të pyllëzimit/ripërtëritjes bimore;

- përgatitjen e preventivëve të detajuar, vlerësimeve të kostos, specifikimeve teknike dhe inputeve për prokurimin e fazës së zbatimit;

- shqyrtimin paraprak mjedisor dhe social, përfshirjen e palëve të interesit, elementet që lidhen me vlerësimin bazë të biodiversitetit, klauzolat për Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMP) dhe një kuadër praktik monitorimi;

- mbështetjen teknike për mbikëqyrjen gjatë zbatimit, përfshirë shënimet e vizitave në terren, verifikimin e cilësisë së zbatimit, masat korrigjuese dhe rekomandimet për pranimin e punimeve.

Aktiviteti pritet të mbështesë ndërhyrje të targetuara dhe në shkallë të vogël, të bazuara në zgjidhje natyrore dhe masa të menaxhimit të qëndrueshëm të tokës, të cilat reduktojnë ndotjen nga burime jopikësore, rrjedhjet e nutrientëve dhe ngarkesat sedimentare të shkaktuara nga erozioni, duke përmirësuar njëkohësisht mbulesën bimore dhe qëndrueshmërinë mjedisore në Pellgun e Lumit Vjosa. Periudha e Kontratës është 6 (gjashtë) muaj nga data e fillimit.

Termat e Referencës (TOR) për këtë detyrë gjenden bashkëlidhur te linku: <https://mjedisi.gov.al/newsroom/kerkese-per-shprehje-interesi-2/>.

Ministria e Mjedisit fton tani firmat e kualifikuara konsulente (“Konsulentët”) të shprehin interesin e tyre për ofrimin e Shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të paraqesin informacion, që demonstroi se ata zotërojnë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për kryerjen e shërbimeve. Konsulentët duhet të plotësojnë kërkesat minimale të mëposhtme:

Konsulenti duhet të jetë një firmë ose konsorcium i regjistruar ligjërisht, me përvojë të dëshmuar, në:

- shërbime të asistencës teknike që lidhen me pyllëzimin, ripërtëritjen bimore, menaxhimin e qëndrueshëm të tokës, kontrollin e erozionit, pylltarinë, menaxhimin e pellgjeve ujore ose zgjidhjet e bazuara në natyrë;

- përgatitjen e planeve të investimit, vlerësimeve të fizibilitetit ose parafizibilitetit, projekteve të detajuara, specifikimeve teknike, preventivëve, vlerësimeve të kostos ose planeve të zbatimit për ndërhyrje mjedisore në terren;

- pyllëzim/ripërtëritje bimore, krijim të brezave riparianë, stabilizim të shpateve, masa të kontrollit të erozionit, restaurim të pellgjeve ujore, përmirësim të kullotave ose zgjidhje të bazuara në natyrë për mbrojtjen e cilësisë së ujit;

- hartëzim dhe dokumentim në terren duke përdorur pajisje dhe mjete të përshtatshme, përfshirë GPS, dronë aty ku lejohet, tableta ose mjete të tjera për mbledhjen e të dhënave, pajisje matëse dhe pajisje përkatëse të sigurisë.

Konsulenti duhet të dëshmojë:

- të paktën 5 (pesë) vjet përvojë të dëshmuar në shërbime të asistencës teknike në fushat përkatëse;

- përfundimin me sukses të të paktën 3 (tri) angazhimeve të ngjashme për nga natyra dhe kompleksiteti;

- përvojë të provuar në përgatitjen e planifikimit të investimeve dhe dokumentacionit teknik të gatshëm për prokurim për ndërhyrje mjedisore, pyjore, restaurimi të tokës, kontrolli të erozionit ose menaxhimi të pellgjeve ujore;

- kapacitet për të angazhuar një ekip multidisiplinar me ekspertizë në pylltari/inxhinieri pyjore, zgjidhje të bazuara në natyrë dhe kontroll erozioni, GIS/teledeteksion, agronomi/ përmirësim kullotash, shqyrtim mjedisor dhe social dhe mbikëqyrje të zbatimit në terren.

Kriteret e përzgjedhjes paraprake janë:

- Aktiviteti kryesor i kompanisë dhe vitet e përvojës në treg – 30 pikë;

- Përvoja e mëparshme në angazhime të ngjashme – 60 pikë;

- Disponueshmëria e stafit të kualifikuar brenda kompanisë për realizimin e detyrës – 10 pikë.

Ekspertët kryesorë nuk do të vlerësohen në këtë fazë.

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet te seksioni III, paragrafët 3.14, 3.16 dhe 3.17 të “Rregulloreve të prokurimit për huamarrësit e IPF-së” të Bankës Botërore, të shtatorit 2023 (“Rregulloret e Prokurimit”), ku përcaktohet politika e Bankës Botërore mbi konfliktin e interesit.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera për të rritur kualifikimet e tyre, por duhet të



tregojnë qartë nëse bashkimi është në formën e një bashkimi të përbashkët (*joint venture*) dhe/ose nënkonsulence. Në rast bashkimi të përbashkët, të gjithë partnerët në bashkim do të jenë përgjegjës, së bashku dhe veç e veç, për të gjithë kontratën, nëse përzgjidhen.

Një Konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën e përzgjedhjes mbi bazën e Kualifikimeve të Konsulentit (CQS), të përcaktuar në Rregulloret e Prokurimit.

Për informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni në adresën më poshtë gjatë orarit zyrtar 09:00–16:00, nga e hëna në të enjte, dhe 09:00–13:00, të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (personalisht, me postë, ose me *email*) deri më **27 korrik 2026**.

Zyra e Protokollit

Projekti Mjedis i Pastër dhe me Aftësi Ripërtëritëse, Deti Blu

Për: Z. Elton Nino, Menaxher i Projektit
Ministria e Mjedisit

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 1,
1001, Tiranë

Email: elton_nino@live.com

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST CONSULTING SERVICES – FIRMS SELECTION

Country:	ALBANIA
Name of the Project:	Clean and Resilient Environment for Blue Sea (Care4BlueSea)
IBRD Loan No.:	95070-AL
Project ID	P176163
Number:	
Assignment Title:	“Technical Assistance for Investment Planning in Afforestation, Pasture Improvement and Erosion Control”
Reference No.:	AL-MTE-2.3.1-1-CS-CQS

The Ministry of Environment has received financing from the World Bank toward the cost of the Care4BlueSea initiative and intends to apply part of the proceeds for consulting services.

The consulting services (“the Services”) include the preparation of a field-verified, costed and

implementable investment plan for afforestation/revegetation, pasture improvement and erosion-control interventions in prioritized locations of the Vjosa River Basin. The Services shall be practical, evidence-based and suitable for direct use in the next implementation phase, including:

- inception, data collection and methodology for site selection, suitability analysis, field verification and stakeholder coordination;

- GIS/environmental diagnostics, field verification and prioritization of intervention sites in the Vjosa River Basin;

- selection of appropriate restoration and establishment models, prioritizing low-risk, low-maintenance and cost-effective approaches where suitable;

- preparation of detailed technical designs, GIS maps, drawings, specifications, implementation notes and maintenance requirements for the priority afforestation/revegetation intervention;

- preparation of itemized Bills of Quantities, cost estimates, technical specifications and procurement inputs for the implementation phase;

- preliminary environmental and social screening, stakeholder inputs, biodiversity baseline assessment considerations, ESMP clauses and a practical monitoring framework;

- technical supervision support during implementation, including site-visit notes, verification of implementation quality, corrective measures and acceptance recommendations.

The assignment is expected to support targeted, small-scale nature-based solutions and sustainable land-management measures that reduce non-point source pollution, nutrient runoff and sediment loads caused by erosion, while improving vegetation cover and environmental sustainability in the Vjosa River Basin. The Contract Period is six (6) months from the Commencement Date.

The Terms of Reference (TOR) for the assignment can be found in the link: <https://mjedisi.gov.al/newsroom/kerkese-per-shprehje-interesi-2/>.

The Ministry of Environment now invites eligible consulting firms (“Consultants”) to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform



the Services. The Consultants shall fulfill the following minimum requirements:

The Consultant shall be a legally registered firm or consortium with demonstrated experience in:

- technical assistance services related to afforestation, revegetation, sustainable land management, erosion control, forestry, watershed management or nature-based solutions;

- preparation of investment plans, feasibility or pre-feasibility assessments, detailed designs, technical specifications, Bills of Quantities, cost estimates or implementation plans for field-based environmental interventions;

- afforestation/revegetation, riparian buffer establishment, slope stabilization, erosion-control measures, catchment restoration, pasture improvement or nature-based solutions for water-quality protection;

- mapping and field documentation using appropriate equipment and tools, including GPS units, drones where permitted, tablets or other data-collection tools, measuring equipment and related safety equipment.

The Consultant should demonstrate:

- at least five (5) years of demonstrated experience in technical assistance services related to the relevant fields;

- successful completion of at least three (3) assignments of similar nature and complexity;

- proven experience in preparing investment planning and procurement-ready technical documentation for environmental, forestry, land-restoration, erosion-control or watershed-management interventions;

- capacity to mobilize a multidisciplinary team with expertise in forestry/forest engineering, nature-based solutions and erosion control, GIS/remote sensing, agronomy/pasture improvement, environmental and social screening and field implementation supervision.

The shortlisting criteria are:

- 1.- Core business and years in business – 30 points;

- 2.- Past experience in similar assignments – 60 points;

- 3.- Availability of qualified staff among the firm to perform the assignment – 10 points.

Key Experts will not be evaluated at this stage.

The attention of interested Consultants is drawn to Section III, paragraphs, 3.14, 3.16, and

3.17 of the World Bank's "Procurement Regulations for IPF Borrowers" September 2023 ("Procurement Regulations"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Consultants may associate with other firms to enhance their qualifications but should indicate clearly whether the association is in the form of a joint venture and/or a sub-consultancy. In the case of a joint venture, all the partners in the joint venture shall be jointly and severally liable for the entire contract, if selected.

A Consultant will be selected in accordance with the Consultant's Qualifications based Selection (CQS) method set out in the Procurement Regulations.

Further information can be obtained at the address below during office hours 09.00-16:00 from Monday to Thursday and 09.00-13.00 Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by email) by **July 27, 2026**.

Protocol Office

Clean and Resilient Environment for Blue Sea Project

Attn: Mr. Elton Nino, Project Manager

Ministry of Environment

Address: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
No. 1, Tirana, Albania

Email: elton_nino@live.com



NJOFTIM

Nr. 334/7, datë 9.7.2026

**PËR PROCEDURËN KONKURRUESE
PËR KONTRATËN “PROJEKTIMI
DHE ZHVILLIMI NËPËRMJET
SIPËRMARRJES I OBJEKTIT
MULTIFUNKSIONAL NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE NR. 7, ZONA
URBANE E ISH-FUSHËS SË
AVIACIONIT, TIRANË”**

Zhvilluesi i Projektit të Investimit:	Korporata e Investimeve Shqiptare
Emri i Projekteve të Investimit:	“Korpusi i institucioneve të pavarura” dhe “Qendra për zhvillimin multifunksional”, Tiranë
Titulli i kontratës:	Projektimi dhe zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i objektit multifunksional në Njësinë Administrative nr. 7, zona urbane e ish-Fushës së Aviacionit, Tiranë
Shpallur më:	9 korrik 2026

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, këtu “Korporata”, është një shoqëri tregtare aksionare, me kapital 100% shtetëror, e cila ka si aksionar të vetëm ministrinë përgjegjëse për ekonominë të Republikës së Shqipërisë.

2. Korporata, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 27.2.2026, për transferimin të Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin, ndër të tjera, të projekteve të investimit “Korpusi i institucioneve të pavarura” dhe “Qendra për zhvillimin multifunksional Tiranë”, është autorizuar për të vepruar si zhvilluese e këtyre projekteve të investimit.

3. Projekti i investimit realizohet nëpërmjet një modeli partneriteti, ku Korporata ka rolin e zhvilluesit të pronave shtetërore në pronësi të saj dhe partnerëve publikë, përfitues në këtë projekt dhe partnerit privat, që posedon burimet financiare, njerëzore dhe ekzekutive, dhe ka interes në realizimin e projektit të investimit. Projekti do të realizohet nëpërmjet instrumentit të

sipërmarrjes, ku partneri privat do të projektojë dhe do të zhvillojë në Tiranë dy objekte me funksion publik, konkretisht objektin publik “Korpusi i institucioneve të pavarura” në zonën urbane në Njësinë Administrative nr. 2, Tiranë, dhe “Qendrën për zhvillimin multifunksional, Tiranë”, ku përfshihen klinika e re mjekësore dhe palestra sportive komunitare publike në Njësinë Administrative nr. 7, Tiranë. Objektet publike financohen nga pjesa takuese e Korporatës në objektin multifunksional për sipërmarrje, i cili, gjithashtu, projektohet dhe zhvillohet nga partneri privat në pronën e Korporatës në zonën e ish-Fushës së Aviacionit, Njësia Administrative nr. 7, Tiranë, në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 119/2026 dhe nr. 137/2024.

4. Konkurrimi për përzgjedhjen e partnerit privat do të kryhet nëpërmjet procedurës konkurruese përzgjedhëse me pikëzim, me 2 (dy) faza/3 (tri) zarfe, përkatësisht faza e kualifikimit dhe faza e përzgjedhjes, siç specifikohet në “Rregulloren për procedurën e konkurrimit”, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës, seksioni “Rreth nesh/ligjet dhe rregulloret”. Procedura është e hapur për të gjitha subjektet, persona fizikë ose juridikë, privatë apo publikë, vendës apo të huaj.

5. Aplikantët mund të aplikojnë në bashkëpunim me “Nënkontraktorë të specializuar” të përzgjedhur nga vetë ata, për ofrimin e shërbimeve të nevojshme të përcaktuara në këtë procedurë. Aplikantët mund të përdorin kualifikimet e “Nënkontraktorëve të specializuar”, për të plotësuar kushtet e kualifikimit, në lidhje me shërbime të lidhura apo pjesë të kontratës, në përputhje me përcaktimet për “Nënkontraktorët e specializuar” në seksionin I, “Udhëzimet për aplikantët” në “Dokumentin e kualifikimit” dhe seksionin IV, nënseksioni 4, “Nënkontraktorët e specializuar”, të “Dokumentit të kualifikimit”.

6. “Dokumenti i Kualifikimit” është i hartuar në gjuhët shqip dhe anglisht dhe është publikuar në faqen e internetit të Korporatës, seksioni “Thirrje/thirrje të hapura/zgjidh projektin”.

7. Faza e kualifikimit (faza I) konsiston në paraqitjen e një aplikimi nga subjektet e interesuara, aplikim i cili përmban 2 projektidetë paraprake arkitekturore dhe dokumentacionin, që vërteton plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kualifikimit të aplikantëve. Vetëm kandidatët e



kualifikuar në fazën e parë do të ftohen në fazën e dytë të konkurrimit nëpërmjet dërgimit të “Ftesës për propozim”.

8. Faza e përzgjedhjes (faza II) konsiston në paraqitjen e një propozimi, i cili përmban dy zarfe të ndara: a) zarfi i parë përmban 2 projektide arkitekturore: i. projektidenë për ndërtesën e Korpusit të Institucioneve të Pavarura; dhe ii. projektidetë për objektin multifunksional për sipërmarrje dhe objektin e Qendrës për Zhvillimin Multifunksional, Tiranë, e cila përfshin klinikën mjekësore dhe palestrën sportive komunitare; dhe b) zarfi i dytë përmban ofertën financiare vetëm për zhvillimin e objektit multifunksional për sipërmarrje, në Njësinë nr. 7, Tiranë. Kjo fazë synon përzgjedhjen e projektideve arkitekturore nëpërmjet një konkursi të hapur publik në praninë e një jurie ndërkombëtare dhe të propozimit financiar më të favorshëm për Korporatën të paraqitur nga një partner i kualifikuar. Në etapën e parë vlerësohen projektidetë arkitekturore, sipas termave të referencës dhe kriterëve të vlerësimit për projektidetë arkitekturore, të cilat mund të konsultohen në seksionin IV, nënseksioni 2, “Termat e referencës për projektidetë arkitekturore”, të “Dokumentit të kualifikimit” dhe jepen çmimet për projektidetë e propozuara arkitekturore të renditura në 5 vendet e para. Në etapën e dytë vlerësohen ofertat financiare në zbatim të metodologjisë së përzgjedhjes së kandidatit fitues të kontratës, përcaktuar në seksionin II, pikat 6 dhe 7, të “Dokumentit të kualifikimit”.

9. Ofertat financiare të paraqitura nga kandidatët në fazën e dytë duhet të plotësojnë kriterin bazë, i cili është **35% (tridhjetë e pesë për qind)** e sipërfaqes totale të zhvillimit të objektit multifunksional për sipërmarrje në pronën e Korporatës në zonën e ish-Fushës së Aviacionit, Njësia Administrative nr. 7, Tiranë, me një sipërfaqe maksimale për t’u projektuar dhe për t’u zhvilluar prej rreth **50,000 metra katrorësh**, të cilat më pas renditen sipas kriterit përzgjedhës si vijon:

a) përqindja më e lartë e sipërfaqes së ofruar për Korporatën mbi kriterin bazë, të përlllogaritur mbi sipërfaqen totale të metrave katrorë të objektit multifunksional për sipërmarrje, të zhvilluar në pronën e Korporatës në zonën e ish-

Fushës së Aviacionit, Njësia Administrative nr. 7, Tiranë.

10. Kontrata fitohet nga kandidati që është vlerësuar nga juria me çmimin e parë të projektidesë arkitekturore në objektin multifunksional për sipërmarrje, nëse ka paraqitur një ofertë financiare, me përqindjen më të lartë për Korporatën, mbi kriterin bazë, sipas përcaktimeve të kriterit përzgjedhës. Në kontratë, partneri privat merr përsipër, që me kërkesë të Korporatës, nga pjesa takuese e saj në objektin për sipërmarrje të ndërtuar në pronën e Korporatës në zonën e ish-Fushës së Aviacionit, Tiranë, të hartojë dhe të zhvillojë plotësisht projektidetë arkitekturore të dy objekteve me funksion tërësisht publik të projekteve të investimit “Korpusi i institucioneve të pavarura” dhe “Qendra për zhvillimin multifunksional Tiranë”, sipas projektideve arkitekturore fituese në konkursin e zhvilluar në këtë procedurë konkurruese në pronat përkatëse.

11. Ky “Njoftim i procedurës konkurruese” hap fazën e parë të procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit. Në këtë fazë do të kualifikohen kandidatët e renditur në 5 vendet e para, të cilat:

a) plotësojnë kriteret e kualifikimit;

b) do të paraqesin projektidetë paraprake arkitekturore të projekteve, e cila renditet në 5 (pesë) projektidetë më të vlerësuara;

c) marrin përsipër, nëse përzgjidhen, të plotësojnë angazhimet si vijon, të cilat përbëjnë kushtet paraprake të kontratës së sipërmarrjes:

i. angazhimin për pagesën e shpenzimeve të konkursit ndërkombëtar të përzgjedhjes së projektideve arkitekturore për projektet e investimit;

ii. angazhimin për pagesën e vlerës së projektit të detajuar arkitekturor të konceptidesë fituese të konkursit;

iii. angazhimin për sistemimin në ambiente pune të përshtatshme, të punonjësve të institucioneve publike, që aktualisht punojnë në pronat objekt i këtij projekti investimi, për të gjithë periudhën e ndërtimit, deri në dorëzimin e pronës për zhvillim publik (me kërkesë të Korporatës);

iv. angazhimin për pagesën e vlerës së taksave, tarifave dhe kontributeve, në kuadër të aplikimit për leje zhvillimi, leje ndërtimi, mbikëqyrjen e



punimeve apo çdo fazë të zhvillimit të pronës deri në regjistrimin e pronës së zhvilluar;

v. angazhimin për regjistrimin e objekteve të reja dhe kalimin e pjesëve takuese të partnerit publik/Korporatës me shpenzimet e partnerit privat;

vi. angazhimin që me kërkesë të Korporatës, nga pjesa takuese e Korporatës në objektin për sipërmarrje të ndërtuar në pronën e Korporatës në zonën e ish-Fushës së Aviacionit, Tiranë, të zhvillojë dy objektet me funksion publik të projekteve të investimit “Korpusi i institucioneve të pavarura” dhe “Qendra për zhvillimin multifunksional, Tiranë”, sipas projektideve arkitekturore fituese në konkursin e zhvilluar në këtë procedurë konkurruese në pronat përkatëse.

12. Të interesuarit mund të marrin informacion të mëtejshëm nga Korporata, në adresën më poshtë gjatë ditëve të punës, në intervalin 09:00–17:00, ora lokale, apo në adresën e *email*-it: competition@aicorporation.al

13. Aplikimet duhet të përgatiten dhe të dorëzohen në gjuhët shqip ose anglisht. Dokumentet shoqëruese të aplikimit, nëse janë në gjuhë të ndryshme nga gjuhët shqip dhe anglisht duhet të përkthehen në njërin nga këto gjuhë.

14. Aplikimet mund të dorëzohen elektronikisht me *email*, dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri më datë **4 shtator 2026, ora 15:00, ora lokale**. Hapja e aplikimeve do të bëhet menjëherë në afatin e fundit për dorëzimin e tyre në adresën e mëposhtme:

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova” 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania

Email: competition@aicorporation.al

Adresa e faqes së internetit: <https://aicorporation.al/>

NOTICE OF THE COMPETITION PROCEDURE

Developer of Investment Project:	Albanian Investment Corporation
Investment Project Title:	“The Independent Institutions Complex” and “Multifunctional Development Center, Tirana”
Contract Title:	Design and development through private enterprise of a multifunctional facility in Administrative Unit No. 7, urban area of the former Aviation Field, Tirana
Launched on:	July 09, 2026

1. The Albanian Investment Corporation, referred to as “the Corporation”, is a new joint-stock company with 100% state capital, whose sole shareholder is the Ministry of Economy, Culture and Innovation of the Republic of Albania.

2. The Corporation, pursuant to Council of Ministers Decision No. 119, dated 27.02.2026, regarding the transfer of state-owned properties under the administrative responsibility of various state institutions to the Albanian Investment Corporation, for the implementation, among others, of the investment projects “Independent Institutions Complex” and “Tirana Multifunctional Development Center”, is authorized to act as the developer for these investment projects.

3. The investment project is implemented through a partnership model, where the Corporation acts as the developer of state-owned properties under its ownership and those of public partners – who are beneficiaries of this project – and the private partner, who possesses the financial, human, and executive resources and has an interest in the implementation of the investment project. The project will be implemented through an enterprise instrument, whereby the private partner will design and develop two facilities with public functions in Tirana: specifically, the public facility “Independent Institutions Complex” in the urban



zone of Administrative Unit No. 2, and the “Tirana Multifunctional Development Center”, which includes a new medical clinic and a public community sports gym in Administrative Unit No. 7. The public facilities are financed by the Corporation’s allocated share in the multifunctional enterprise building, which is also designed and developed by the private partner on the Corporation’s property in the former Aviation Field area, Administrative Unit No. 7, in accordance with Council of Ministers Decisions No. 119/2026 and No. 137/2024.

4. The competition for selecting the private partner will be conducted through a competitive selection procedure with scoring, structured in 2 (two) phases/3 (three) envelopes, namely the qualification phase and the selection phase, as specified in the “Regulation for the Competition Procedure,” published on the Corporation’s official website, section “About Us/by laws and Regulations”. The procedure is open to all entities, whether individuals or legal entities, private or public, domestic or foreign.

5. Applicants may apply in collaboration with Specialized Subcontractors selected by them. Applicants may utilize the qualifications of Specialized Subcontractors to meet the qualification requirements related to specific services or parts of the contract, in accordance with the provisions for “Specialized Subcontractors” outlined in Section I, Instructions to Applicants, of the Qualification Document, and in Section IV, Subsection 4, Specialized Subcontractors, of the Qualification Document.

6. The Qualification Document is prepared in Albanian and English and is published on the Corporation’s website, section “Calls/Open Calls/Select the Project”.

7. The Qualification Phase (Phase I) consists of the submission of an application by interested entities, which contains two (2) preliminary architectural design concepts and documentation verifying the fulfillment of the qualification conditions and criteria for applicants. Only candidates qualified in the first phase will be invited to the second phase of the competition through the issuance of an Invitation for Proposal (IFP).

8. The Selection Phase (Phase II) consists of the submission of a proposal containing two separate envelopes: a) the first envelope contains two architectural design concepts: i. the architectural concept for the Independent Institutions Complex building, and ii. the architectural concepts for the multifunctional enterprise building and the Tirana Multifunctional Development Center, which includes the medical clinic and the community sports gym; and b) the second envelope contains the financial offer solely for the development of the multifunctional enterprise building in Unit No. 7, Tirana. This phase aims to select the architectural design concepts through an open public competition in the presence of an international jury, and the most favorable financial proposal for the Corporation submitted by a qualified partner. In the first stage, the architectural design concepts are evaluated according to the terms of reference and the evaluation criteria for architectural concepts, which can be consulted in Section IV, sub-section 2, “Terms of Reference for architectural design concepts” of the Qualification Document; prizes are awarded for the proposed architectural concepts ranked in the top five places. In the second stage, the financial offers are evaluated in accordance with the methodology for selecting the winning candidate for the contract, as specified in Section II, points 6 and 7, of the Qualification Document.

9. The financial offers submitted by candidates in the second Phase must fulfill the baseline criterion, which is 35% (thirty-five percent) of the total development area of the multifunctional enterprise building on the Corporation’s property in the former Aviation Field area, Administrative Unit No. 7, Tirana, with a maximum design and development area of approximately 50,000 square meters; these shall subsequently be ranked according to the selection criteria as follows:

a) the highest percentage of the area offered to the Corporation above the basic criterion, calculated over the total square meter area of the multifunctional enterprise building developed on the Corporation’s property in the former Aviation Field area, Administrative Unit No. 7, Tirana.

10. The contract is awarded to the candidate whose architectural design concept for the multifunctional enterprise building has been



ranked first by the Jury, provided they have submitted a financial offer with the highest percentage for the Corporation above the basic criterion, as defined by the selection criteria. In the contract, the private partner undertakes that, at the Corporation's request and from the Corporation's allocated/designated share in the enterprise building constructed on its property in the former Aviation Field area, Tirana, they shall fully design and develop the architectural design concepts for the two entirely public-function investment projects, the "Independent Institutions Complex" and the "Tirana Multifunctional Development Center", based on the winning architectural concepts from the competition held during this competitive procedure on the respective properties.

11. This Notice of the Competitive Procedure opens the first phase of the competitive procedure for selecting the Partner. In this phase, the candidates ranked in the top 5 (five) positions will be qualified, who:

- a) meet the qualification criteria;
- b) present the preliminary architectural project ideas, which is ranked among the 5 (five) most highly evaluated project ideas;
- c) commit, if selected, to fulfill the following obligations, which constitute the preliminary conditions of the contracting agreement:
 - i. commitment to cover the expenses of the international competition for selecting the architectural project idea for the project;
 - ii. commitment to pay the value of the detailed architectural project of the winning concept idea of the competition;
 - iii. commitment to provide suitable temporary workspaces for public institution employees currently operating on the properties subject to this investment project, for the entire duration of construction, until the property is handed over for public development (upon the Corporation's request);
 - iv. commitment to pay the value of taxes, fees, and contributions, within the framework of the application for development permits, building permits, construction supervision, or any phase of property development until the registration of the developed property;
 - v. commitment to register the new objects and transfer the relevant portions to the Public

Partner/Corporation at the expense of the private partner;

vi. commitment that, at the Corporation's request and from the Corporation's designated share in the enterprise building constructed on its property in the former Aviation Field area, Tirana, [the partner] shall develop the two public-function investment projects, the "Independent Institutions Complex" and the "Tirana Multifunctional Development Center", in accordance with the winning architectural design concepts from the competition held during this competitive procedure on the respective properties.

12. Interested parties can obtain further information from the Corporation at the address below during working days, from 09:00 to 17:00 local time, or at the email address: competition@aicorporation.al.

13. Applications must be prepared and submitted in Albanian or English. The accompanying documents of the application, if in a language other than Albanian or English, must be translated into one of these languages.

14. Applications can be submitted electronically via email, in person, or by post to the address below, no later than **15:00 hrs, local time, on September 04, 2026**. The opening of applications will take place immediately after the deadline for submission at the address below:

Albanian Investment Corporation

Address: Rruga "Ibrahim Rugova" 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania

Email: competition@aicorporation.al

Website: <https://aicorporation.al/>

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2026



||BULETINI ZYRTAR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË||Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 17|Datë: 13.07.2026 13:19:00
+02:00|a8025d88-3913-460f-9ca1-f84563ac1eb7

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)